



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

KESHILLI BASHKIAK BELSH

Nr ____ Prot

Belsh më ____/____/ 2024

PROCES-VERBAL

I mbledhjes së këshillit bashkiak të datës 27.03.2024 me 15 këshilltarë prezentë, në mbështetje të ligjit 139/2015 për vetëqeverisjen vendore. Njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar nëpërmjet formatit elektronik.

Janë prezent në mbledhje 15 këshilltarë:

1. Asqeri Kuqja
2. Erion Gjoshi
3. Erjon Qafa
4. Naime Ibrahimimi
5. Bujar Blloku
6. Nexhip Elezi
7. Gezim Gjoshi
8. Aurela Hysa
9. Kujtim Dervishi
10. Blerim Kuqja
11. Nertila Uruci
12. Aurjola Bezati
13. Ismail Paja
14. Sami Uruci
15. Gazeli Hysa

Hapet mbledhja e këshillit bashkiak nga kryetari I këshillit z.Kujtim Dervishi. Hidhet në miratim rendi i ditës dhe miratohet me 12 vota pro dhe 2 kunder.

Diskutohet process verbali i mbledhjes së kaluar. Propozon N.Uruci që process verbali të jetë më i zgjeruar.

Propozon E.Gjoshi që komisionet të mblidhen 1 orë përpara mbledhjes së këshillit. Përgjigjet E.Hyka ,që sipas ligjit komisionet duhen mbeldhur minimalisht 1 ditë përpara mbledhjes së këshillit.

Kryetari i këshillit lexon rregulloren,ku thuhet që komisionet duhet të mblidhen 5 ditë para mbledhjes së këshillit bashkiak.

Diskuton B.Kuqja mbi buxhetin e këshillit bashkiak.Përgjigjet K.Dervishi që duhet të presim diskutimin e drejtorin e financës në lidhje me ceshtjen e buxhetit.

-Diskutohet Ndhima Ekonomike dhe mbron përgjegjësja e Ndhimës E.Dërvishi.Diskuton A.Bezati mbi numrin e aplikantëve të ndihmës ekonomike.Propozon I.Paja që të sillet informacion mbi listën totale të aplikantëve.

-Kryetari i këshillit hedh në votim P/vendimin për ndihmën ekonomike dhe miratohet me 15 vota pro dhe asnjë kundër.

-Propozon kryetari i këshillit që të kalohet te pika nr.8 e rendit të ditës.Kalohet te pika e 8-të e rendit të ditës për dhënien me qera të sipërfaqes së fondit pyjor dhe kullosor.

-Diskuton I.Paja : Cilat janë pronat që do të jepen me qera? Përgjigjet përgjegjësja e zyrës A.Dervishi: Jepen të gjitha pronat që kanë certifikatë pronësie nga Bashkia.Pronat arë jepen me qera nga Ministria e Bujqësisë.

G.Hysa: Ka prona që janë në gjyq me bashkinë.

A.Dervishi: Bashkia Belsh njih certifikatën e pronësisë që ka dalë nga zyrat e ASHK,nëse gjykata vendos të bllokojë pronat,atëherë bashkia njih vendimin e gjykatës.

I.Paja: Cfarë procedure duhet për të marrë me qera një pronë?

A.Dervishi: Cdo person i interesuar paraqet kërkesën në bashki dhe tarifat janë të ndryshme.

-K.Dervishi: Kush është dakort me projekt vendimin?

A.Bezati: Kërkojmë më shumë sqarime.

Punonjësja A.Dervishi: Pronat do të jepen me qera për panele fotovoltaike dhe për mbarëshkrimin e faunës.Bashkëngjitur p/vendimit është edhe raporti ekonomik.

-I.Paja : Ku ndodhen pronat që do të jepen me qera?

-E .Gjoshi: Informacioni duhet të kërkohet në mënyrë më të shkurtuar.

-Kujtim Dervishi: Kush është dakort me projekt vendimin? **Projekt vendimi nuk miratohet me 5 vota kundër dhe 9 pro.**

-Kalojmë te pika e 4 në rendin e ditës për miratimin e tavanëve të shpenzimeve për projekt buxhetin 2025-2027.

-N.Uruci: Kërkojmë të kalohet pagesa e këshilltarëve (shpërblimi).Cilat janë arsyet që nuk kanë kaluar?

-K.Dervishi: Cilat janë arsyet që nuk kanë kaluar ?

-A.Nipolli: Muajin që vjen do të likujdohen shpërblimet e këshilltarëve.

-B.Kuqja : Cfarë parashikon buxheti i këshillit bashkiak për lëvizjen e këshilltarëve?

-A.Nipolli: Nuk parashikohet pagesa e këshilltarëve për lëvizje nën 100 km.

-Diskuton kryetari i këshillit që të bëhet një plan pune për lëvizje dhe të kërkojmë mjetet e bashkisë për lëvizjet.

-Diskutohet projekt vendimi nr.4 dhe nr.5 për tavanet e shpenzimeve dhe tavanet e të ardhurave,për projekt buxhetin deri në vitin 2027. A.Nipolli sqaron që në këto projekt vendime nuk miratohen objekte ,por janë objektiva ose plan për 2 vitet e ardhshme.

-E.Gjoshi: Këto janë plan për vitet e ardhshme?

-A Nipolli : Këto janë objektiva.

-Diskuton B.Blloku : Pse planifikimi i taksës mbi ndërtesën është shumë më i lartë se fakti?

Përgjigjet A.Nipolli: Kemi taksa mbi ndërtesën të mbartura nga vitet e kaluara dhe udhëzimi nga Ministria e Financave bën që të gjitha objektet ti nënshtrohen taksave.

-Hidhet në votim P/Vendimi nr.5 dhe kalon me 13 vota pro dhe 2 kundër.

-Hidhet në votim P/Vendimi nr.4 dhe kalon me 13 vota pro dhe 2 kundër.

-Kalojmë te pika nr.6 e rendit të ditës ,për disa ndryshime në buxhetin 2024.

Diskuton B.Kuqja që të ketë më shumë sqarim për këtë vlerë për të cilën kërkohet miratimi.

Përgjigjet A.Nipolli që kjo vlerë është mbi bazën e kontratës me IADSA të miratuar mbledhjen e kaluar.

-Hidhet në votim projekt vendimi dhe miratohet me 12 vota pro,2 kundër dhe 1 abstenim.

-Kalojmë te pika e 7-të e rendit të ditës,për bashkëfinancimin për bonus qeratë.**Hidhet në votim dhe miratohet me 14 vota pro.**

-Kalojmë te pika e 1-rë e të ndryshmeve,për zonjën Fatime Cela për ndihmë financiare.Këshilli vendos që ti kalojë zyrës.

-Diskutohet kërkesa e Gëzim Muces . Këshilli vendos që ti kalojë zyrës.

-Diskutohet kërkesa e Adelina Dervishit dhe vendoset që ti kalojë zyrove për më shumë informacion.

B.Kuqja: Kërkojmë informacion nga zyra e Tatim Taksave meqënëse sot nuk ka ardhur.

N.Uruci: Kërkojmë që mblëdhjen e ardhshme të kemi informacion mbi detyrat e lëna nga KLSH.

Mbyllet mbledhja e këshillit me 5 vendime të miratuara.

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA